

VLERAT KULTURORE DHE TRASHËGIMIA E KRAHINËS SË DROPULLIT

Prof. As. Dr. SOFIA DELIJORGJI

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti i Tiranës
sofia.delijorgji@unitir.edu.al

Msc. AIDA ZOTO

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti i Tiranës

ABSTRACT

The province of Dropulli represents an ethno-cultural destination that inherits a rich and diverse spiritual cultural wealth. Located between two cultures, Albanian and Greek, Dropulli offers endless things to know and visit. In a fabulous landscape, this totally rural area keeps alive with much love and nobility their hospitality, language, literature and civilization, beautiful dances, polyphony, rich costumes, Epirote clarinet motifs, churches and monasteries, archaeological sites, architectural characteristics, crafts, the processing of agricultural and livestock products, the gastronomy related to tradition, and while the essential oils and medicinal plants represent another natural wealth of this area. Dropulli, a tourist area not yet fully explored, is an open invitation to all explorers of nature and natural beauty attracting more and more visitors.

In this paper, all these elements, ethnographic and cultural features passed down and inherited from generation to generation will be presented.

Keywords: Dropulli, civilization, culture.

Trashëgimia kulturore

Trashëgimia kulturore, si një mekanizëm i cili tregon identitetin kulturor të një zone, krahine, grupi ose shoqërie, vazhdimisht evoluon. Vlerat e saj përbëhen nga attribute të prekshme dhe të paprekshme, natyrore dhe të krijuara nga njeriu, të luajtshme dhe të paluajtshme. David Lowenthal, historian dhe gjeograf i njohur për punën e tij mbi trashëgiminë, thekson rëndësinë e trashëgimisë kulturore në botën aktuale të globalizmit, konflikteve, presioneve të zhvillimit dhe migrimit¹; ndërsa sipas nenit 2 të Konventës Faro 2005² “(...) trashëgimia kulturore është grup i burimeve të trashëguara nga e kaluara, të cilat njerëzit i identifikojnë, pavarësisht nga pronësia, si pasqyrim dhe shprehje e vlerave, besimeve, njohurive dhe traditave vazhdimisht në evoluim. Ajo përfshin të gjitha aspektet e mjedisit që vijnë nga ndërveprimi midis njerëzve dhe vendeve në raport me kohën”.

Në thelb, trashëgimia kulturore e çdo zone përfshin pasurinë kulturore materiale dhe jomateriale, si një tërësi vlerash kulturore, mbartëse të kujtesës historike dhe identitetit kombëtar, duke përfshirë pronën kulturore e njohur edhe si kultura materiale (të tillë, si: ndërtesat, monumentet, peizazhet, librat, veprat e artit dhe objektet e ndryshme), kulturën shpirtërore, (të tilla, si: folklori, traditat, gjuha dhe njohurit tradicionale), si dhe trashëgiminë natyrore (duke përfshirë peizazhet e rëndësishme kulturore). Trashëgimia kulturore, duke mbartur rëndësi shkencore ose kulturore, mund të jenë në pronësi të shtetit, të bashkësive fetare të regjistruara, si dhe personave fizikë ose juridikë privatë dhe mbrohet përmes Ligjeve, VKM, Urdhrave, Konventave, Statuteve, Rregulloreve etj., nga instancat përkatëse të çdo shteti³.

¹ Lowenthal, D., The Past is a Foreign Country (E kaluara është një vend i huaj) (Kembrixh: Cambridge University Press, 1985).

² Convention on the Value of Cultural Heritage for Society (Faro Convention, 2005), Council of Europe <https://www.coe.int/en/web/culture-and-heritage/faro-convention>

³ Trashëgimia Kulturore <https://kultura.gov.al/trashegimia-kulturore/>

Bashkia Dropull

Bashkia e Dropullit ndodhet në Qarkun e Gjirokastrës dhe shtrihet në pjesën juglindore të vendit. Kjo bashki përbëhet nga 3 njësi administrative, të cilat janë: Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm dhe Pogoni.

Dropulli karakterizohet nga një traditë e pasur historike dhe kulturore, e cila fillon që në kohët e lashta, dhe vazhdon gjatë kohës bizantine dhe mesjetës, siç dëshmohet nga kishat bizantine dhe pasbizantine, pallatet dhe urat, të ndërtuara nga mjeshtrit dropullitë. Dropulli, i njohur edhe si *Dhrinopoleos* apo dhe *Dheropoli*⁴, gjendet në pjesën jugore të një luge të ngushtë, e cila shtrihet nga lartësitë e malit Stugara – në kufirin greko-shqiptar. Ai gjendet në pozicion gjeografik të përshtatshëm, në degëzimin e rrugës nacionale Gjirokastrë – Kakavi dhe Gjirokastrë – Sarandë⁵. Gjirokastra, afërsisht në mes të kësaj luge, shënon kufirin verior të Dropullit. Një pjesë e konsiderueshme e pakicës kombëtare greke jeton në këtë zonë⁶.

Emri i tij vjen nga qyteti i lashtë grek Drys ose Dryinoupolis (gr. Δρυς ose Δρυϊνούπολις), qyteti i lisave, i cili e ka marrë këtë emër gjatë kohës së sundimit të August Cezarit, pas vitit 27 para. K., ndërsa në Synekdeum-in e Hierokleus-it ai numërohet ndër dymbëdhjetë qytetet e Kontinentit të Vjetër.

Sipas Pouqueville, i cili merr informacion nga Plini, thuhet se themeluesja e qytetit është Dryope (gr. Δρυόπη), e bija e Oichalius (gr. Οϊχάλιος), të cilën Apolloni e magjepsi dhe e shndërroi në një lis. Versioni tjetër mbi emërtimin e kësaj zone është se emri rrjedh nga lisat që mbizotërojnë ndër pemët e pakta të zonës, pasi në këtë zonë, ndodhet edhe mali Dryiniko (gr. Δρυϊνικό Όρος), si dhe lumi Drynos (gr. Δρύνος)⁷.

⁴ Dropulli në kohë dhe në hapësirë, Bashkia Dropull <https://www.bashkiadropull.gov.al/dropulli-ne-kohe-dhe-ne-hapesire/>

⁵ Bashkia Dropull – Pasaporta <https://portavendore.al/bashkia-dropull/pasaporta-e-bashkise-drro-pull/>

⁶ Sipas hulumtimit të Open Data Albania mbi popullatën e minoriteteve kombëtare dhe kulturore në Shqipëri (Census 2011) rezultoi se minoriteti grek në Bashkinë Gjirokastrë arrin në 19,921 vetë <https://ndiqparate.al/?p=15147>

⁷ Η ονομασία και γεωγραφική τοποθεσία της επαρχίας Δρυϊνουπόλεως <https://dropolinews.gr/history/i-onomasia-kai-geografiki-topothesia-tis-eparxias-dryinoupoleos>

Pa dyshim, zona e Dropullit është një nga rajonet më të bukura të pakicës kombëtare greke, e famshme për bukurinë e saj natyrore, klimën e shëndetshme, bimësinë e pasur, mirësinë dhe hirin e grave të saj dhe idiomën e bukur gjuhësore. Traditat e banorëve të Dropullit dhe bukuria e zonës u lartësuan që në fillim të shekullit të 19-të nga udhëtarët nga vende të ndryshme të Evropës Perëndimore si Pouqueville, Holland, Isambert etj.⁸

George D. Kapsalis, profesor në Departamentin Pedagogjik të Arsimit Fillor të Universitetit të Janinës dhe ish-Rektor i Universitetit të Janinës, në librin e tij me titull “Αναζητώντας τα δύο αδέρφια (shq. Duke kërkuar dy vëllezërit)” shprehet: “Ishte e pamundur të mos e kishe zili këtë fushë të hijshme. Shtrihet nga lindja në perëndim dhe shuan etjen nga lumi që e shoqëron dhe i ofron një paqe e qetësi të papërshkrueshme shpirti... Gjithë fusha plot tufa, plot dele e kambana, plot tinguj dhe melodi, nga hallet dhe vuajtjet njerëzore. Tokë e bekuar që pasurinë dhe bukurinë tënde ua dhurove tufave, njerëzve që të zgjodhën dhe të besuan... Fytyra të dashura, të njohura e të panjohura, që gjete në këtë tokë të bekuar e të hidhur... të përulem duke të nderuar, duke soditur fushën e Dropullit... fushën e gjerë, gjelbërimin dhe hirin e saj”⁹.

Për sa i përket formimit të tokës, ajo është përgjithësisht shumë pjellore, ndërsa malet shkojnë nga perëndimi në lindje dhe janë të përbërë nga shkëmbinjtë gjelqerorë. Që në lashtësi, për shkak të tokës së thatë, ka pasur edhe pemë si: bajame dhe plepa, të cilat janë rezistente ndaj thatësisë, duke theksuar gjithashtu edhe ekzistencën e pemës së lisit, i cili konsiderohej një pemë e shenjtë nga Epirotët.

Pasura e trashëgimisë kulturore, historike dhe fetare të zonës së Dropullit

Monumentet e trashëgimisë kulturore, historike dhe fetare të zonës së Dropullit janë simbole të rëndësishme që tregojnë vlerat materiale, shpirtërore dhe zhvillimin në shekuj dhe vite. Zona ofron burime dhe

⁸ Δημήτριος Ε. Ευαγγελίδης, Η Βόρειος Ήπειρος, Βιβλιοπωλείον Ιωάννου Ν. Σιδέρης, Βοτίμη: Σύλλογος προς Διάδοσιν Ωφέλιμων Βιβλίων, Αθinë 1919, f. 75.

⁹ Γεώργιος Δ. Καψάλης, Αναζητώντας τα δύο αδέρφια, botimët. Τυπωθῆτω, Αθinë 2005, f. 85- 88

atraksione natyrore që favorizojnë si turizmin familjar, ashtu edhe aktivitete të ndryshme turistike në natyrë.

Sipas Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, në rrethin e Gjirokastrës kemi rreth 545 monumente të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje nga të cilat rreth 40 i takojnë Bashkisë së Dropullit¹⁰.


• *Monumentet kulturore dhe historike - Urat prej guri*

Për shkak të tejmbushjes së Drinos dhe jo vetëm, në stinën e dimrit fshatrat komunikojnë me njëri-tjetrin nëpërmjet urave të gurta. Ato janë të shpërndara në të gjithë zonën dhe karakterizohen nga eleganca e tyre, guximi i ndërtimit, thjeshtësia dhe harmonia e tyre me mjedisin natyror. Kështu, urat lidhin vendbanimet me njëra-tjetrën por edhe lagjet e çdo fshati me vendet e punës - arat, vreshtat, kullotat. Urat e gurta janë ndërtesa karakteristike dhe një shembull jashtëzakonisht i teknikës së shkëlqyer që zotëronin mjeshtrit dropullitë.

Integrimi absolut i urave në mjedisin natyror bëri që studiuesi Spyros Mandas (1984) të pohonte se njerëzit, për të plotësuar një nevojë të menjëhershme (atë të komunikimit), u detyruan të zgjeronin vetë natyrën, duke ndërtuar këto kryevepra të arkitekturës popullore në harmoni të plotë me peizazhin natyror përreth. Ndër më të famshmet janë¹¹:



Ura në fshatin Haskovë



Ura e Glinës

• *Monumentet kulturore dhe historike - Vende arkeologjike*

Dropulli ka shumë vende arkeologjike, monumente kulturore dhe historike të cilat ndërtojnë një rrugë me përmbajtje historike dhe

¹⁰ Lista e Monumenteve të Kulturës - Qarku Gjirokastrë

http://iktk.gov.al/site/wp-content/uploads/2020/10/Monumentet_-_Qarku-Gjirokastrer.pdf

¹¹ <https://turizmi.gov.al>

kulturore për vizitorin dhe i japin atij mundësinë që të njohë historinë dhe kulturën e zonës. Zona, duhet të ketë qenë e banuar që shumë kohë më parë, pasi gërmimet arkeologjike të kryera në fushën e Dropullit, në luginën e Drinos, kanë nxjerrë në dritë gjetje arkeologjike që tregojnë gjurmët e periudhës helenistike para asaj të Romës.


Monumentet e trashëgimisë kulturore dhe historike të zonës së Dropullit janë simbole të rëndësishme që tregojnë vlerat materiale, shpirtërore dhe zhvillimin në shekuj dhe vite. Zona ofron burime dhe atraksione natyrore që favorizojnë si turizmin familjar, ashtu edhe aktivitete të ndryshme turistike në natyrë. Sipas Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, në rrethin e Gjirokastrës kemi rreth 545 monumente të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje nga të cilat rreth 40 i takojnë Bashkisë së Dropullit. Ndër më të famshmet janë¹²:



*Kalaja e Selos
ujëmbledhësi*



Kalaja e Pepelit



*Varri monumental dhe
(Jurgucat)*

• *Monumentet kulturore dhe historike - Monumentet kishtare*

Dropulli është vendi ku lulëzoi dhe mbijetoi deri më sot tradita e pasur greke dhe bizantine, pasuria e madhe folklorike dhe muzika unike popullore polifonike. Kishat në fshatrat e Dropullit janë të pafundme dhe mbartin vlera dhe kulturë shekullore përgjatë historisë. Manastire të reja të gdhendura pranë vendbanimeve antike. Të dhënat historike dëshmojnë për ekzistencën e kishave të ndryshme të vogla nga shekulli i V pas K., të cilat janë bazilika të hershme të krishtera. Manastiret dhe kishat zhvillohen në institucione për të arritur kulmin e tyre në epokën e Komnenëve dhe Paleologëve. Disa të vogla e të tjera më madhështore, janë jo vetëm vend kulti, por edhe ndërtesa historike me interes të veçantë arkitekturor. Ndër më të famshmet janë¹³:

¹² <https://turizmi.gov.al>

¹³ <https://turizmi.gov.al>




*Manastiri i Shën Mërisë
(Goranxi)*



*Kisha e Manastirit të
Metamorfozës (Çatistë)*



*Kisha e Manastirit të
profet Ilias (Jorgucat)*



*Manastiri i Shën Qirjakut dhe Juditës
(Dhuvjan)*



*Ikonostasi i të kishës së Shën Thanasit
(Bularat)*

• *Veshjet mbresëlënëse tradicionale dropullite*

Veshjet e përdorura e zonës së Dropullit janë të larmishme dhe elegante, të zbukuruara shumë herë me shije të hollë. Ato flasin jo vetëm për një nivel ekonomik mjaft të ngritur, por edhe për shije estetike mjaft të zhvilluara. Dëshmi për këtë janë veshjet e grave të Dropullit, në të cilat, ka një harmoni të përkryer midis pjesëve të veçanta që përbëjnë kostumin. Karakteristikë e përbashkët e veshjeve të grave është përdorimi i cohës ngjyrë blu të errët, nganjëherë me nuanca drejt të zezës. Parapëlqimi i ngjyrave të errëta duket se ka pasur lidhje me kushtet shoqërore të së kaluarës, kur mërgimi ekonomik i burrave

mori përpjesëtime të mëdha. Në Dropull përdorim më të gjerë kishte liri, por krahas tij përdorej edhe leshti. Për më tepër, në këto zona, të banuara nga pakicat greke, përkatësia e ndryshme etnike e popullsisë shfaqej edhe në kostumet e tyre popullore.

Kur shqyrton veshjet e grave të kësaj zone, ajo që të tërheq vëmendjen është harmonia e të gjitha pjesëve kryesore që përbëjnë kostumin. Asaj i japin individualitet të veçantë dy shkallëzime që krijohen (njëri në pjesën e poshtme dhe tjetri në pjesën e sipërme të saj) si pasojë e të veshurit njëra mbi tjetrën të pjesëve që e përbëjnë. Në të poshtmen vijnë me radhë: këmisha e pastaj *fusta* (fundi), pjesët fundore të të cilave janë të zbukuruara me kllapodan; e treta, fermeleja e, mbi të, coha. Shkallëzimi tjetër, ai i pjesës së sipërme, krijohet tek kyçi i dorës. Së pari, shihet mënga e gjerë e këmishës e punuar me dantellë, pastaj mënga e dollomasë që është prerë në formën e një trapezi; së fundi, mënga e gjerë shumë e zbukuruar, e mantos prej cohe ose kadifeje. Kostumet lokale janë tradicionalisht të zbukuruar me qëndisma të komplikuar, dantella dhe punime me grep e qëndisma¹⁴. Veshja e grave të Dropullit të Poshtëm ishte shumë e afërt me atë të Dropullit të Sipërm. Kështu, shajaku (apo shita), këmisha, mbulesa e kokës dhe mënyra e lidhjes së saj dallonin vetëm në elemente të dorës së dytë, ndërsa veshja e Rrëzës së Buretos ishte e njëjtë me veshjen e përdorur në Dropullin e Poshtëm¹⁵.

- *Kostumi i nuses dropullite*

Kostumi i nuses dropullite është ndër kostumet më të bukura në fondin e etnografisë shqiptare dhe diversitetit kulturor tradicional. Kjo veshje tradicionale e zonës vazhdon edhe sot të përgatitet në të gjitha proceset e saj prej prerjes, vizatimit dhe qëndisjes në mënyrë krejtësisht artizanale¹⁶. Kostumi përbëhej nga një *kavadhi* (këmishë) i qëndisur me fije ari dhe argjendi dhe përfshinte zbukurime dhe bizhuteri, pëlhura të shtrenjta, dantella dhe qëndisje me fije ari.

¹⁴ Akademia e Artit dhe Trashëgimisë ODEA <http://odeacademy.org/veshje-grash>

¹⁵ Akademia e Artit dhe Trashëgimisë ODEA <http://odeacademy.org/veshje-grash>

¹⁶ Ministria e Kulturës. Shoqata Kulturore Artistike “Dropulli”: “Zonja e kostumeve” (Minoriteti grek në Shqipëri) <https://kultura.gov.al/en/shoqata-kulturore-artistike-dropulli-zonja-e-kostumeve-minoriteti-grek-ne-shqiperi/>

Veshja e nuses kthehet në një monument kulturor të gjallë unik të identitetit kombëtar, për të treguar forcën e vet, nivelin arsimor, mirësinë dhe optimizmin¹⁷.



Burimi: H φορεσιά της Δρόπολης - κείμενα και φωτογραφίες (Kostumi i Dropullit - tekste dhe fotografi) <http://filipjovanis.blogspot.com/2013/11/blog-post.html>

¹⁷Akademia e Artit dhe Trashëgimisë ODEA <http://odeacademy.org/veshje-grash>

- *Veshja e burrave të Dropullit*

Veshja më përfaqësuese për burra ka qenë kostumi me fustanellë. Kostumet tradicionale të burrave përfshijnë poture të bardha leshe, të gjëra në bel që përfundojnë të ngushta tek këmbët dhe shoqërohen me dollakë te pulpat ose fustanellat e bardhë me pala, të shoqëruara me jelek dhe opinga me xhufka. Në kokë mbahej një kapllak i gjatë e i zi, prodhuar me lesh qengji ose një qeleshe prej shajaku me majë. Tipar i përbashkët ishte fustanella, jeleku, opingat, kësula. Ngjyra e mëngores ishte blu e thellë drejt së zezës. Një tjetër element, qylafi (kapelja), ka ndryshuar dy herë formë; deri në vitet e Pavarësisë Kombëtare përdorej një feste e kuqe, me një xhufkë disi të gjatë që varej deri përmbi supe, ndërsa më pas filloi të përdorej gjithnjë e më shumë një kësulë prej belluzi ose kadifeje të zezë. Veshja plotësohej me brezin e gjerë mbi të cilin ngjishej silahu, ku burri mbante armët e brezit. Si veshje e rëndë dimri për burra mbahej bërruci i zi¹⁸.



Burimi: <http://filipjovanis.blogspot.com/2013/11/blog-post.html>

¹⁸Akademia e Artit dhe Trashëgimisë ODEA <http://odeacademy.org/veshje-burrash>

- *Vallja dropullite (dropullitçe)*



Burimi: Ansambli Dropulli, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike, maj 2019

Vallja e vajzave dropullite, e emërtuar nga fakti se ko valle e ka burimin dhe origjinën nga zona etno-kulturore e Dropullit, është një folklor instrumental dhe koreografik. Tipologji e trashëgimisë shpirtërore të minoritetit etnik grek, pjesë e diversitetit kulturor në Shqipëri, që nga viti 2010 është pjesë e listës kombëtare të kryeveprave të trashëgimisë kulturore shpirtërore. Është një valle e shtruar me hapa të shkurtër e kursyer në lëvizje që vë në pah hijeshinë dhe pasurinë e kostumeve të zbukuruar me qëndisma ari, monedha të florinjta mbi ballë në gjoks. Vallja dropullitçe njihet edhe si koreografi, por edhe si melodi (valle të kënduara dhe valle me saze). Vallet e marrin emrin nga kënga që i shoqëron, p.sh. *Pogobishte, Gajtanaqi, Kostandas, Vllaha, Kleftes, Aleksandra; Karaguna, Osman Taga* (vallja e burrave), *Karakaksa* (vallja e vajzave) etj.¹⁹

- *Kënga Polifonike dhe tradita muzikore*

Kënga Polifonike, një zhanër me origjinë të lashtë, është një traditë e gjallë dhe një element i identitetit kulturor të popullsisë së Dropullit.

¹⁹ Kulturë shpirtërore nga Dropulli

<http://www.arkivalajmeve.com/Kulture-shpirterore-nga-Dropulli.1046947261/>

Në të njëjtën kohë, është një nga shembujt më të rëndësishëm në repertorin e polifonisë globale. Është një fenomen etnomuzikologjik me origjinë antike ku struktura dhe stili i interpretimit të tij krijojnë një nga format më interesante në repertorin e polifonisë popullore botërore. Kënga Polifonike, shprehet Labros Liavas, Drejtor i Departamentit të Etnomuzikologjisë dhe Antropologjisë Kulturore në Universitetin Kombëtar dhe Kapodistrian të Athinës është *“një nga format muzikore më interesante jo vetëm në Mesdheun Lindor dhe Ballkan, por edhe në repertorin global të polifonisë popullore”*. Kënga polifonike epirote është një shprehje e gjallë, e përbashkët, një element identifikues kulturor i popullsisë kufitare, që përbën një “pasaportë” kulturore midis kufijve dhe popujve fqinjë. Një grup polifonik përbëhet nga të paktën katër këngëtarë, por mund të arrijë edhe në dhjetë. Këngëtari kryesor, si rol drejtues, koordinon grupin, duke dhënë ritmin dhe melodinë, duke përcaktuar marrëdhënien me zërat e tjerë. Çdo zë ka “hapësirën” e tij brenda këngës dhe kontribuon në shprehjen e pasionit kolektiv apo personal të shprehur si grup. Këngëtarët janë afër njëri-tjetrit dhe shpeshherë formojnë një rreth. Nuk ka instrumente muzikore. Kjo është arsyeja pse zërat janë kaq të bashkuar. Kënga Polifonike gjatë gjithë kohës ka qenë një element integral i përditshmërisë së banorëve të saj. Ajo shoqëron profesionet e tyre, punën në fusha dhe blegtorinë, ciklin zakonor dhe sezonal të kohës dhe jetës së tyre²⁰.

BIBLIOGRAFIA

- Arkivi i Isopolifonisë Shqiptare. Sazet e Dropullit ndër vite, Gjirokastrë <http://isopoli1.w03.wh-2.com/ShowSaze.aspx?id=42>
- Arkivi i Isopolifonisë Shqiptare. Sazet e familjes Mastora, Dropull <http://isopoli1.w03.wh-2.com/ShowSaze.aspx?id=8>
- Bashkia Dropull, Projekti Bashki të Forta & Smart Processes. 2019. Bashkia Dropull – Raporti i Performancës 2019 <http://bashkiteforta.al/wp-content/uploads/2021/02/Raporti-Performanc%C3%ABs-Dropull-FINAL.pdf>
- Çuko, P. 1964. Këngëve popullore. Rrev. Ylli, nr. 11, 12. <https://www.himara.gr/istoria/7694-syntomi-gnorimia-istoria-deropolis>

²⁰ (Λάβδας, Α. (1957) Πεντάφθογγες κλίμακες εν τη Δημώδη Μουσική της Ηπείρου (Ανάτυπο εκ του Ζ' τόμου της “Ηπειρώτικης Εστίας”)

<https://www.searchculture.gr/aggregator/edm/kemnepp/000126-76605>

Kasoruh. N. 2003. Mes këngëve dhe valleve të Dropullit. Toena.

Kasoruh. N. 2000. Gjirokastra e festivalit. Tiranë.

Loli. K. 1985. Veçori muzikore të valleve të minoritetit grek, Skena dhe ekrani

Loli. K. 2003. Kaba dhe Avaze. Janinë, Greqi.

Ministria e Kulturës. Shoqata Kulturore Artistike “Dropulli”: “Zonja e kostumeve” (Minoriteti grek në Shqipëri) <https://kultura.gov.al/en/shoqata-kulturore-artistike-dropulli-zonja-e-kostumeve-minoriteti-grek-ne-shqiperi/>

Tase. P. & Loli. K. 2003. Naxhi Kasoruh, Mes këngëve dhe valleve të Dropullit. Tiranë. TOENA

Γενικό επιτελείο Ελληνικού Στρατού (1913). Χάρτης Εθνογραφικός της Β. Ηπείρου (1913).

Γιώτης Α. 2003. Εδεσματολόγιον Ηπείρου. Ελληνικά γράμματα.

Καλιβρετάτης, Λεωνίδας. Η Ελληνική κοινότητα της Αλβανίας από την σκοπιά της ιστορικής γεωγραφίας και δημογραφίας.

Κοκολάκης, Μιχάλης. Η Τουρκική στατιστική της Ηπείρου στο σαλναμέ του 1895.

Μ.Β. Σακελλαρίου (επιμ.), Ήπειρος: 4000 χρόνια ελληνικής ιστορίας και πολιτισμού, Εκδοτική Αθηνών, Αθήνα 1997 ISBN 960-213-371-6, ISBN-13 978-960-213-371-2 [σειρά: Ιστορικοί Ελληνικοί Χώροι]

Μαμμόπουλου. Α. Χ. 2013. ΛΑΪΚΕΣ ΦΟΡΕΣΙΕΣ/ ΑΝΔΡΙΚΗ ΕΝΔΥΜΑΣΙΑ/ ΦΟΡΕΣΙΑ ΤΗΣ ΔΡΟΠΟΛΗΣ.

Παπα, Ευτυχία. Η Επαρχία Δρυινουπόλεως της Βορείου Ηπείρου κατά την νεότερη περίοδο. Θεσσαλονίκη.

Παπαδόπουλος, Νίκος (1970). Η Δούβιανη της Δροπόλης Β. Ηπείρου. Αθληνα.

Παπαδόπουλος, Νίκος (1976). Η Δρόπολη της Βορείου Ηπείρου κατά την Τουρκοκρατίαν (1430-1913). Αθήνα.

Παπαδόπουλου Κ.Ν. 2013. ΔΡΟΠΟΛΙΤΙΚΟΣ ΓΑΜΟΣ/ ΗΣΤΟΛΗ ΤΗΣ ΔΡΟΠΟΛΙΤΙΣΣΑΣ ΝΥΦΗΣ.

Χατζημιχάλη. Α.2013. Η ΕΛΛΗΝΙΚΗ ΛΑΪΚΗ ΦΟΡΕΣΙΑ/ Η ΦΟΡΕΣΙΑ ΤΗΣ ΔΡΟΠΟΛΗΣ.